

AXHENDA

MBLEDHJA XXXIII KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)

SFIDAT E SEKTORIT PRIVAT: ADMINISTRIMI FISKAL, INOVACIONI, PRODUKTIVITETI

Data: 26 Mars 2024 (martë) ora:11³⁰ – 13⁰⁰

Vendi: Salla Ovale, Pallati i Kongreseve

11:30 – 11:40	Mirëseardhje dhe Miratim i Axhendës së Mbledhjes <i>Z. Blendi Gonxhja, Kryetar i KI/Ministër i Ekonomisë, Kulturës, Inovacionit</i>
11:40 – 11:50	Prezantim “Mbi Sfidat e Sektorit Privat – Ndërveprimi Fiskal, Inovacioni, Produktiviteti” <i>Sekretariati i Këshillit të Investimeve</i>
11:50 – 12:50	Diskutim i fokusuar nga Anëtarët e KI <p>a) <i>Stabiliteti fiskal dhe mirëadministrimi efikas janë thelbësorë për një klimë të favorshme biznesi dhe konkurrueshmëri në tregjet rajonale dhe globale. Pavarësisht progresit në komunikim dhe dixhitalizim, sfidat mbeten në drejtim të paqëndrueshmërisë fiskale, profesionalizmin administrativ dhe angazhimin e palëve të interesuara në hartimin e strategjive dhe legjislacionit fiskal.</i></p> <p>b) <i>Rritja e përpjekjeve për të frenuar aktivitetet ekonomike informale mbetet një objektiv kyç për administratën tatimore, me përmirësime periodike si zbatimi i sistemeve të menaxhimit të rrezikut dhe fiskalizimi. Megjithatë, ulja e informalitetit në sektorë të caktuar mbetet një sfidë e vazhdueshme, që kërkon bashkëpunim me institucione të tjera.</i></p> <p>c) <i>Integrimi rajon dhe më gjerë i ekonomisë shqiptare kërkon ritheksimin e politikave të duhura për rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat, kryesisht duke mbështetur rritjen e produktivitetit të firmës dhe integrimin e Inovacionit në të gjithë sektorët e ekonomisë.</i></p> <p>d) <i>Një mjedis konkurrues, i qëndrueshëm dhe suportiv ndaj të bërit biznes qëndron në thelb të një ekonomie që lulëzon e zhvillohet. Klima e të bërit biznes në vend duket se ndikohen në masë më të madhe nga legjislacioni fiskal dhe ai i inspektimeve të cilët perceptohen nga biznesi se shkaktojnë barrë të shtuar administrative për ta.</i></p>
12:50 – 13:00	Miratimi i Rekomandimeve dhe Mbyllja e Mbledhjes <i>Z. Blendi Gonxhja, Kryetar i KI/Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit</i>